

SHTOJCA 1**Formulari i kërkesës për leje mjedisore**

Emri i kompanisë	“ Italy Recycling” L.L.C.
Lloji i veprimtarisë	Qendrën e Mbledhjes, Grumbullimit, Transportimit, Trajtimit Fizik, Ripërdorimit, Përpunimit, Magazinimit, dhe Riciklimit të Mbeturinave të Letrës, Plastikës, Qelqit, Mbeturinave Metalike dhe Vajrave të Përdorura
Vendi/Lokacioni ku zhvillon Veprimtarinë	Obiliq, Komuna e Obiliqit
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës i kompanisë	Fidan Latifaj,
Adresa	Rr. Vëllezërit Dervishaj nr. 30, Pejë
Telefoni, fax, e-mail	+383 45 500 712,
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	Fidan Latifaj,
Adresa	Rr. Vëllezërit Dervishaj nr. 30, Pejë
Përshkrimi i dokumentacionit bashkangjitur kërkesës, përfshirë numrin e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	Certifikata e regjistrimit të Biznesit me nr. Unik Identifikues:810804204, 15.07.2010 Formulari i plotësuar sipas kushteve në shtojcën 1, Pëlqimi Mjedisor me nr. 188-2/25, 29.07.2025
Deklarimi i vlerës financiar të investimit të projektit (euro), nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë	185,500.00 €
Fatura e pagesës së tarifës për Lejes Mjedisore	Po
Aplikacioni origjinal i plotësuar për leje mjedisore në Pesë(5) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD)	Po



Shtojca 2

Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE

1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME


1.1. Të dhënat për Operatorin

1.1.1.	Emri i subjektit	“ Italy Recycling” L.L.C.- Qendrën e Mbledhjes, Grumbullimit, Transportimit, Trajtimit Fizik, Ripërdorimit, Përpunimit, Magazinimit, dhe Riciklimit të Mbeturinave të Letrës, Plastikës, Qelqit, Mbeturinave Metalike dhe Vajrave të Përdorura
	Vendi	Obiliq, Komuna e Obiliqit
	Adresa	Zona II Rr. H.Prishtina te Hiri
	Nr. i tel./fax	+383 45 500 712
	E-mail	italyrec.llc@gmail.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	810804204, Data e regjistrimit - 15.07.2010
1.1.3.	Personi Përgjegjës i kompanisë	Fidan Latifaj, pronar
	Nr. i tel./fax	+383 45 500 712
	E-mail	italyrec.llc@gmail.com

1.2. Të dhënat për kompanin

1.2.1.	Emri i kompanisë	“ Italy Recycling” L.L.C.- Qendrën e Mbledhjes, Grumbullimit, Transportimit, Trajtimit Fizik, Ripërdorimit, Përpunimit, Magazinimit, dhe Riciklimit të Mbeturinave të Letrës, Plastikës, Qelqit, Mbeturinave Metalike dhe Vajrave të Përdorura
1.2.2.	Adresa e lokacionit të kompanisë	Zona II Rr. H.Prishtina te Hiri


2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur	Objekti i qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, ndodhet në ngastrën kadastrale me nr. 01914-6, 01914-7 dhe 01796-5, Zona kadastrale Obiliq, komuna e Obiliqit. Objekti ku është e ndërtuar është zone industriale e Obiliqit. Kjo qe nder e mbeturinave gjendet larg qytetit diku 3.8 km . 
D	Numri kadastral i parcelës	Objekti i qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, ndodhet në ngastrën kadastrale me nr. 01914-6, 01914-7 dhe 01796-5, Zona kadastrale Obiliq, komuna e Obiliqit. 

2.3.


Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë


Lokacioni i qendrës për grumbullimin, seleksionimin, presimin dhe ambalazhimin e mbeturinave të letrës, plastikës, kanaçeve të aluminit, makina të vjetra, baterive dhe vajrave të përdorura, gjendet në Zonën kadastrale nr.O – 72614055-01914-6, O – 72614055-01914-7 dhe O – 72614055-01796-5 në komunën e Obiliqit, ku kufizohet me Milloshevë, Mazgit, Orloviq, Kryshevc, Caravodicë, Leshkoshiq dhe Plemetin.



Afer kësaj qendre, shtëpi banimi me e afërta është paraqitur në ortofoton e mëposhtme ku distanca më e afërt është mbi 290 metra, por kjo distance nuk e pengon funksionimin e qendrës se mbeturinave e cila është e ndërtuar qe nga viti 2010.



		Rreth kësaj qendre kemi edhe disa lloje te ndryshme industriale te cilat veprojnë ne kete zone dhe ato janë: Haje Shpk, Messer Medica, Fiat Toplica, Rgb L.L.C, Korporata Rugove etj. 
2.4.	Të dhënat lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	Në territorin e Komunës, gjer me tani, nuk ka ndonjë zonë që është shpallur e mbrojtur në bazë të legjislacionit në fuqi për shkak të vlerave të biodiversiteti apo ekosistemeve me rendesi. Ekosistemet natyrore në një pjesë të territorit të Komunës në masë të madhe është i ndikuar nga minierat, deponitë e djerrinave, termocentralet dhe deponitë e hirit të “TC-A dhe TC-B”, kështu qëkemi një pamje të ashpër të peizazhit natyror. Në pjesët tjera të territorit të Komunës kemi njëpamje të mirë të peizazhit natyror. Në planet e ardhshme, zona e mihjeve ekzistuese, depozitat e hirit dhe depozitimet e djerrinës do të pastrohen, ri-kultivohen dhe mbillen, rrjedhë që vazhdimisht do të përmirësohet pamja vizualee peizazhi natyror. Në territorin e Komunës ekzistojnë vetëm disa monumente natyrore siç janë: Burim i ujit mineral në Grabofc të Epërm; Burim/krua në qendër të fshatit Caravadicë; Trung druri i vetëm bliri, i vjetër rreth 200 vjet, në lagjen Nicak (Sibovc) dhe; Grup trungjesh druri të bungut, diku rreth 300 vjeçar, në lagjen e

		Megjuanëve (Sibovc). Në afërsi të fshatrave mund të gjendet vegjetacion i vrazhdë. Biotopet natyrore gjenden afër lumit “Sitnica” dhe përfshijnë livadhet e lagështa, komunitetin e llojeve të bimëve barishtore, dhe llojet e drurit të ahut, lisit, shkurret etj., që gjinden në perëndim. Ndër shpendët e egër të malit e të fushës që ndeshen më shumë janë shqiponja e malit, petriti, grizhlat, sorrat, harabeli, kulumbria, bufi, lakuriqi i natës etj. Ndër kafshët e egra që gjenden veçojmë dhelpren, lepurin, ujkun, derri i egër, buklën, iriqin, breshkën etj. Në ujërat e lumenjve e të kanaleve veçojmë rosat, patat, lejlekun, gjarpërinjtë e ujit, bretkosat, breshkat e ujit, etj. Nga dëmtimi i pyjeve po dëmtohen gjithashtu si flora ashtu edhe fauna e egër. Disa prej tyre janë në zhdukje e sipër si lepuri i egër, thëllëza e malit, shepka e malit, sidomos nga gjuetia e pakontrolluar, si në sezonin e gjuetisë ashtu edhe jashtë sezonit.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtura	Në afërsi të lokacionit ku kërkohet Leja Mjedisore për qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, ndodhet në ngastrën kadastrale me nr. 01914-6, 01914-7 dhe 01796-5, Zona kadastrale Obiliq, nuk ka Zona të veçanta të mbrojtura, apo ndonjë tjetër zonë me interes të veçantë, nuk ka as monumente natyrore apo peizazh të mbrojtur. Në një distancë prej 2.63 km, gjendet një lule e mbrojtur e cila quhet Paoni Dacora Gazmistani, kjo distance është e largët dhe nuk ndikon aspak , veprimtaria e qendrës nga kompania “Italy Recycling” L.L.C. 

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË



3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore

3.1.1.

Skema e procesit teknologjik

Qendra e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, ka për qëllim të menaxhojë mbeturinat në mënyrë që të minimizojë ndikimet negative në mjedis dhe të sigurojë trajtim të sigurt për riciklimin e tyre të mëtejshëm ose depozitim në përputhje me normat mjedisore. Procesi teknologjik përfshin disa faza të rëndësishme që garantojnë menaxhimin efikas dhe të qëndrueshëm të këtyre mbetjeve.

Procesi i punës është ilustruar ne figurën si me poshtë:



3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Për realizimin e procesit të punës kalon nëpër disa faza: Grumbullimi i mbeturinave - Mbeturinat grumbullohen nga burime të ndryshme, si institucione publike, biznese dhe pika të dedikuara të mbledhjes, dhe transportohen në qendër me mjete të specializuara që garantojnë siguri dhe pastërti. Pas mbërritjes në qendër, ato peshohen dhe regjistrohen, përpara se të kalojnë në fazën e seleksionimit. Seleksionimi i mbeturinave - Mbeturinat ndahen në mënyrë manuale në bazë të llojit të materialit: letër, plastikë, metale, vajra, qelq dhe bateri. Kjo fazë është thelbësore për sigurimin e një trajtimi të mëvonshëm të diferencuar dhe për të mundësuar riciklimin sipas standardeve.  <i>Makina që përdoret për seleksionimin e mbeturinave</i> Prerja e mbeturinave të letrës dhe plastikës - Materialet e selektuara si letra dhe plastika i nënshtrohen procesit të prerjes për t'u reduktuar në përmasa të përshtatshme për presim. Kjo ndihmon në përpunim më të lehtë dhe rrit efikasitetin në fazat pasuese.  <i>Makina që përdoret për prerje</i> Presimi i mbeturinave- Mbeturinat e prera dhe të klasifikuara futen në presa
--------	--	---

hidraulike ku kompaktohen për të ulur volumin dhe për të lehtësuar magazinimin dhe transportin. Mbeturinat e presuara formohen në njësi të standardizuara për manipulim më të thjeshtë.



Makina që përdoret për presim të mbeturinave

Lidhja dhe ambalazhimi - Pas presimit, mbeturinat e materialeve lidhen me shirita të veçantë për të siguruar qëndrueshmëri gjatë magazinimit dhe transportit. Kjo siguron integritetin fizik të materialeve gjatë manipulimit të mëtejshëm.



Dukja e mbeturinave të lidhura

Ruajtja dhe transporti - Materialet e përpunuara ruhen në hapësira të mbuluara dhe të ndara sipas llojit, në kushte që parandalojnë ndotjen dhe përkeqësimin e cilësisë. Më pas, ato transportohen për eksport apo për trajtim të mëtejshëm nga operatorë të licencuar.

Riciklimi i mbeturinave - Kompania planifikon të realizojë riciklimin e qeseve të najlonit dhe plastikës përmes një linje të dedikuar teknologjike.

Fillimisht, mbeturinat plastike grumbullohen nga burime të ndryshme dhe klasifikohen sipas llojit të plastikës (PE, PP, PVC), ngjyrës dhe nivelit të ndotjes. Pasi shkarkohen, ato vendosen në shirita transportues dhe i nënshtrohen ndarjes mekanike.



Ndarja mbeturinave te najlonit

Materiali i ndarë copëtohet në grimca të vogla përmes thërmuesve industrialë dhe më pas përpunohet në linjën e larjes që përfshin larje me ujë të nxehtë, fërkim dhe tharje. Pas tharjes, plastika përpunohet në makinë granulimi, ku reduktohet përmbajtja e lagështisë dhe përgatitet për shkrirje.

Granulatet që përftohen përdoren si lëndë e parë për prodhimin e qeseve të reja, bidonëve, kovave, folieve dhe produkteve të tjera plastike.



Makineria e cila përdoret për granulim dhe prodhim të folive dhe qeseve të plastikës



Materiali përfundimtar - Granulat

Procesi i riciklimit të mbeturinave plastike (i planifikuar) Pas realizimit të investimit në vijën teknologjike për riciklim, kompania do të zhvillojë edhe këtë fazë të përpunimit:

Transportimi në linjën e riciklimit - Mbeturinat plastike të seleksionuara do të ngarkohen me pirunë dhe do të vendosen në shiritin transportues për të kaluar në vijën përpunuese.

Grirja dhe pastrimi - Plastika do të copëtohet në një mulli industrial dhe do të pastrohet nga ndotjet fizike.

Shpërlarja dhe tharja - Copat plastike do të kalojnë nëpër vaskat e larjes për t'u pastruar nga mbetjet e etiketimeve, ndotjet organike dhe substanca të tjera. Më pas do të thahen në tharëse industriale.

Shkrirja dhe formësimi në granula - Materiali i tharë do të futet në ekstruder, ku do të shkrihet dhe do të shndërrohet në filament plastik, i cili më pas pritët në formë granulesh.

Paketimi i produktit përfundimtar - Granulatet plastike do të pakëtohen dhe do të ruhen si produkt final për shitje ose për përdorim të mëtejshëm në industri.

Procesi Teknologjik i Prodhimit të Qeseve të Plastikës

Shkrirja në ekstruder - Granulatat plastike (LDPE/HDPE) futen në ekstruder, ku transportohen nga vida rrotulluese në një cilindër të ngrohur në temperaturë 160–220°C. Gjatë kalimit, ato shkrihen në një masë të njëtrajtshme plastike.

Formimi i filmit plastic - Masa e shkrirë kalon nëpër një matrice unazore duke formuar një tub të hollë plastik, ku fryrja me ajër krijon një flluskë filmike. Flluska ftohet dhe sheshohet për të prodhuar një film me trashësi të kontrolluar.

Rrotullimi - Filmi i formuar mbështillet në bobina të mëdha përmes një sistemi automatik të rrotullimit. Këto bobina janë gati për fazën e prerjes dhe formimit të qeseve.

Prerja dhe formimi i qeseve - Filmi në bobina futet në makinën për formim, ku pritët në gjatësi të përcaktuar dhe saldohet në fund për të krijuar formën e qeses. Më pas, mund të shtypet logoja dhe të përpunohen elementët si dorezat apo vrimat për mbajtje.

Paketimi - Qeset e përfunduara palosen, numërohen dhe paketojnë në njësi prej 50, 100 ose 500 copë. Paketimi bëhet në qese të mëdha ose në kuti për transport dhe shpërndarje.

Masat teknike dhe të sigurisë - Temperaturat në ekstruder dhe matrice kontrollohen për të shmangur mbinxehjen dhe formimin e gazrave të dëmshëm. Sistemi përfshin ventilim industrial, sensorë për cilësi dhe trashësi, si dhe pajisje mbrojtëse dhe fikëse për siguri operationale.



Model i prodhimit të qeseve të plastikës

Me poshte do ti paraqesim kodet e mbeturina te cilat do të Mbledhen, Grumbullohen, Transportohen, Trajtohen, Fizikisht, Ripërdoren, Përpunohen, Magazinohen, dhe Riciklohen Mbeturinat e Letrës, Plastikës, Qelqit, Mbeturinave Metalike dhe Vajrave të Përdorura

Tabelave e kodeve te mbeturinave për të cilat është pajisur me Pëlqim Mjedisor kompania "Italy Recycling" L.L.C., Obiliq				
02 01 04	15 01 09	16 06 02*	17 04 04	20 01 11
02 01 10	15 02 02 *	16 06 03*	17 04 05	
03 03 08	16 01 03	16 06 04	17 04 06	20 01 25
07 02 03*	16 01 04*	16 06 05	17 04 07	20 01 33*
07 02 13	16 01 06	16 06 06*	19 12 01	20 01 34
10 03 05	16 01 07*	16 07 08*	19 12 02	20 01 35*
12 01 07*	16 01 09*	16 08 01	19 12 03	20 01 36
12 01 10*	16 01 17	16 08 02*	19 12 04	20 01 38
13 01 01*	16 01 18	16 08 03	19 12 05	20 01 39
15 01 01	16 01 19	17 01 01	19 12 07	20 01 40
15 01 02	16 01 20	17 02 01	19 12 08	20 02 01
15 01 03	16 02 09*	17 02 02	19 12 12	20 03 01
15 01 04	16 02 14*	17 02 03	20 01 01	20 03 02
15 01 05	16 02 15*	17 04 01	20 01 02	20 03 03
15 01 06	16 02 16	17 04 02	20 01 10	20 03 07
15 01 07	16 06 01*	17 04 03		

Kodet e mbet. Trajtimi I Mbeturinës

02 01 04 Mbeturinat nga plastika copëtohen dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim

02 01 10 Mbeturinat metalike grumbullohen dhe seleksionohen

03 03 08 Mbeturinat nga klasifikimi i letrës dhe kartonit te destinuara për riciklim

07 02 03* Tretësira organike te halogjenuara, lëngjet për larje dhe lëngjet baze/ame, te cilat trajtohen përmes procesit te hollimit

07 02 13 Copëtohet dhe shitet tek kompanitë për riciklim

10 03 05 Ndarje fizike, seleksionohet alumini dhe shitet tek kompanitë e përpunimit

12 01 07* Vajra minerale te makinerive qe nuk përmbajnë halogjen, (përveç emulsioneve dhe solucioneve), grumbullohen ne kazanë te inoksit dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim

12 01 10* Vajrat sintetike te makinave grumbullohen ne kazanë te inoksit dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim

13 01 01* Vajrat hidraulike, qe përmbajnë PCB, grumbullohen ne kazanë te inoksit dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim

15 01 01 Asgjësim I ambalazhes se letrës dhe kartonit, ne disa raste kur letra dhe kartoni është I pastër ndahet dhe shitet tek kompanitë e riciklimit

15 01 02 Disa te dëmtuara asgjësohen, ndërsa plastika e pastër dorëzohet

		për riciklim tek kompanitë tjera
	15 01 03	Grumbullim
	15 01 04	Ndarje fizike dhe copitim
	15 01 05	Grumbullim
	15 01 06	Klasifikohen ku disa prej tyre asgjësohen dhe disa copëtohen
	15 01 07	Grumbullohet, klasifikohet dhe dërgohet tek qendrat e grumbullimit te metaleve për përpunim te mëtejme
	15 01 09	Grumbullim
	15 02 02*	Grumbullim, trajtim fizik pastaj dërgohen tek kompanitë për riciklim
	16 01 03	Copëtohen dhe dërgohen tek kompanitë për ripërdorim
	16 01 04*	Ndarje fizike dhe Copëtohen dhe dërgohen tek kompanitë për ripërdorim
	16 01 06	Automjetet jashtë përdorimit qe nuk përmbajnë lëngje apo komponentë tjera te rrezikshme, Ndarje fizike dhe copitim
	16 01 07*	Filtra vaji, grumbullohen ne kazanë te inoksit dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim
	16 01 09*	Komponentët qe përmbajnë PCBs, Grumbullohet, klasifikohet dhe dërgohet tek qendrat e grumbullimit te metaleve për përpunim te mëtejme
	16 01 17	Grumbullohet, klasifikohet dhe dërgohet tek qendrat e grumbullimit te metaleve për përpunim te mëtejme
	16 01 18	Grumbullohet, klasifikohet dhe dërgohet tek qendrat e grumbullimit te metaleve për përpunim te mëtejme
	16 01 19	Mbeturinat nga plastika copëtohen dhe dërgohen tek kompanitë për riciklim
	16 01 20	Grumbullohet dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
	16 02 09*	Trajtimi, seleksionimi dhe dërgohet tek kompanit e reciklimit.
	16 02 14	Grumbullohen
	16 02 15*	Dërgohen tek kompanitë e licencuara për asgjësim
	16 02 16	Grumbullohen
	16 06 01*	Copëtohen, klasifikohen plumbi ndahet dhe shitet tek kompanitë e përpunimit te mëtejme ndërsa plastika asgjësohet
	16 06 02*	Copëtohen, klasifikohen plumbi ndahet dhe shitet tek

	kompanitë e përpunimit të mëtejme
16 06 03*	Copëtohen, klasifikohen plumbi ndahet dhe shitet tek kompanitë e përpunimit të mëtejme
16 06 04	Copëtohen, klasifikohen plumbi ndahet dhe shitet tek kompanitë e përpunimit të mëtejme ndërsa plastika asgjësohet
16 06 05	Copëtohen, klasifikohen plumbi ndahet dhe shitet tek kompanitë e përpunimit të mëtejme ndërsa plastika asgjësohet
16 06 06*	Grumbullim, trajtim fizik
16 07 08*	Grumbullohen, behet ndarja fizike dhe vajrat trajtohen në separator të vajrave , pastaj dorëzohen tek kompanitë e riciklimit
16 08 01	Ndahen fizikisht dhe shiten tek kompanitë e riciklimit në Kosovë
16 08 02*	Grumbullim, trajtim fizik
16 08 03	Grumbullim, trajtim fizik
17 01 01	Grumbullim, trajtim fizik dhe ndarje e hekurit nga betoni
17 02 01	grumbullohet
17 02 02	Grumbullohet dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
17 02 03	Grumbullohet, seleksionohet dhe copëtohet dhe pastaj dërgohet tek kompanitë riciklimit
17 04 01	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit të metaleve
17 04 02	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit të metaleve
17 04 03	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit të metaleve
17 04 04	Grumbullet dhe shitet
17 04 05	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit të metaleve
17 04 06	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit të metaleve
17 04 07	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit të metaleve
19 12 01	Grumbullim, trajtim fizik dhe pastaj dërgon tek qendrat për

	riciklim
19 12 02	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
19 12 03	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
19 12 04	Grumbullohet, seleksionohet dhe copëtohet dhe pastaj dërgohet tek kompanitë riciklimit
19 12 05	Grumbullohet dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
19 12 07	Grumbullim
19 12 08	Grumbullim, dorëzim tek kompanitë e riciklimit
19 12 12	Grumbullim, trajtim fizik
20 01 01	Grumbullim, trajtim fizik, kompaksim dhe shitet tek kompanitë e riciklimit
20 01 02	Grumbullohet dhe dërgohet tek kompanitë e riciklimit
20 01 10	Grumbullim, dorëzim tek kompanitë e riciklimit
20 01 11	Grumbullim, dorëzim tek kompanitë e riciklimit
20 01 25	Grumbullim, dorëzim tek kompanitë e riciklimit
20 01 33*	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
20 01 34	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
20 01 35*	Grumbullim, ndarja fizike
20 01 36	Grumbullim, ndarja fizike
20 01 38	Grumbullim
20 01 39	Grumbullohet, seleksionohet dhe copëtohet dhe pastaj dërgohet tek kompanitë riciklimit
20 01 40	Grumbullohen ndahen fizikisht dhe pastaj dërgohen tek qendrat e grumbullimit te metaleve
20 02 01	Grumbullohen dhe dërgohen ne deponi
20 03 01	Grumbullim, ndarja fizike
20 03 02	Grumbullimi, seleksionimi dhe deponimin ne deponi
20 03 03	Grumbullimi, seleksionimi dhe deponimin ne deponi
20 03 07	Grumbullim, ndarja fizike

3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	8 ore x 5 dit 40 orë në javë orari punës prej orës 08:00 deri 16:00.
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Kapaciteti i projektuar është afro ne vit 24.000 ton Kapaciteti i realizuar ditor:76. Ton Kapaciteti i realizuar mujor:2.000. ton Kapaciteti i realizuar vjetor :24.000. ton
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse.	Lënda e parë - Llojet e mbeturinave të pranuar për trajtim Letër dhe karton Plastikë Qelq Metale Vajrat e përdorura Lënda ndihmëse: Energjia elektrike, Uji për nevoja sanitare dhe nevoja të pastrimit, në rast kur është e nevojshme
3.1.6.	Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre	Qendra për grumbullimin e mbeturinave nuk posedon rezervuar.
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	Lista e Ligjeve dhe rregulloreve, Për plotësimin e formularit për Leje Mjedisore për Qendra të mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letres, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura “Italy Recycling”L.L.C: Ligjet Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 03/L-025 Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233 Ligji nr.08\1-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04\1-060 për

		mbeturina Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 Udhëzimet Administrative Udhëzim Administrativ nr.04/2022 për Leje Mjedisore Udhëzim Administrativ(MMPHI) Nr.01_2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04_2022 për Leje Mjedisore Udhëzimi Administrativ (MMPHI) nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor, Udhëzimi Administrativ nr.13/2013 për katalogun shtetëror të mbeturinave.
--	--	---

3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit

3.2.1	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Sistemi i menaxhimit mjedisor është instrumente që përcakton përgjegjësitë mjedisore për secilin anëtar apo punonjës të kompanisë, duke i ndihmuar ata të kuptojnë ndikimet mjedisore të shkaktuara nga aktivitetet apo veprimtaritë e tyre, si edhe të përcaktojnë objektivat mjedisore për të ulur ndikimet dhe për te përmirësuar performancën e tyre mjedisore. Sistemi i menaxhimit mjedisor paraqitet në formë të ndryshme dhe është ajo pjesë e sistemit të përgjithshëm të administrimit, që përfshin strukturën organizative, aktivitetet e planifikuara, përgjegjësitë, praktik, procedurat dhe burimet për zhvillimin, zbatimin, arritjen, shqyrtimin dhe konsolidimin e praktikave mjedisore. Kompania “Italy Recycling”L.L.C. është e përkushtuar më të gjitha funksionet e sajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një Mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim: Respektimin e legjislacionit vendor Përmirësimin e komunikimit me autoritetet Parandalimin e dëmtimit të Mjedisit
-------	---	---

		Përmirësimin e vazhdueshëm i Mjedisit
3.2.2	Raportimi	

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

4.1.	Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse	Proceset që zhvillohen në kuadër të kësaj qendre janë kryesisht të natyrës fizike dhe mekanike, andaj nuk përfshijnë djegie të lëndëve fosile apo reaksione kimike që do të prodhonin ndotës të rrezikshëm. Megjithatë, gjatë funksionimit të objektit, mund të identifikohen disa pika potenciale të burimeve të ndotjes, të cilat mund të jenë nga pluhuri , zhurma, lëvizja e makineris etj.
4.2.	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Proceset që zhvillohen në kuadër të qendrës së mbeturinave janë të natyrës kryesisht mekanike, prandaj emisionet në ajër janë të karakterit difuz dhe me intensitet të ulët. Ndotja potenciale kryesisht gjenerohet nga pluhuri i pezulluar që çlirohet gjatë manipulimit të mbeturinave të lehta si letra dhe plastika, sidomos në fazën e seleksionimit dhe presimit. Ky pluhur mund të ndikojë në cilësinë lokale të ajrit në ambientet e punës, nëse nuk kontrollohet me sistem ventilimi dhe pastrimi të rregullt. Gjithashtu, gjatë funksionimit të makinerive dhe automjeteve transportuese që përdorin karburant fosil, mund të çlirohen sasi të vogla të gazeve ndotëse si dioksidi i karbonit (CO ₂), oksidet e azotit (NO _x) dhe grimca të imëta (PM ₁₀ /PM _{2.5}), të cilat kontribuojnë në ndotjen urbane dhe ngarkesën atmosferike të zonës. Në rastin e riciklimit të plastikës, veçanërisht gjatë shkrirjes në ekstruder, ekziston mundësia për çlirimin e avujve plastikë dhe komponimeve organike të paqëndrueshme (VOC), por ato parashikohet të neutralizohen përmes ajrosjes industriale dhe kontrollit të temperaturave në linjë.

4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive të emisioneve në qendrën e mbeturinave janë ato që nuk dalin nga një pikë e vetme e identifikueshme, por shpërndahen në mënyrë të shpërndarë nga veprimtaritë operative në ambientet e hapura apo gjysmë të mbyllura. Këto burime janë tipike për veprimtaritë e karakterit mekanik dhe përfshijnë emisione të pluhurit dhe grimcave të imëta të pezulluara që çlirohen gjatë shkarkimit, seleksionimit, prerjes dhe presimit të mbeturinave, sidomos të letres, plastikës dhe materialeve të tjera të lehta. Një ndër burimet kryesore difuzive është lëvizja e vazhdueshme e mjeteve transportuese brenda objektit, e cila ngrit pluhur nga sipërfaqet e dyshemesë ose nga materialet e grumbulluara.. Në linjat e riciklimit të plastikës, gjatë shkrirjes së materialit ekziston rreziku për çlirimin e avujve të nxehtë plastikë dhe të komponimeve organike të paqëndrueshme (VOC), të cilat gjithashtu konsiderohen burime difuzive. Këto emisione, ndonëse të nivelit të ulët, kanë rëndësi për kontroll mjedisor, veçanërisht në ambientet e punës, dhe kërkojnë masa mbrojtëse si pastrim të rregullt të zonave operative, ajrosje mekanike, instalim të aspiratorëve lokalë, mirëmbajtje të dyshemeve dhe ndarje funksionale të zonave për manipulimin e mbetjeve.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Nuk janë të nevojshme pasi nuk ka djegie të mbeturinave
4.5.	Pajisjet për de-pluhurim	Nuk janë të nevojshme
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Monitorimi i emisioneve do të bëhet sipas kërkesave që dalin pasi të pajiset me Leje Mjedisore.
4.7.	Monitorimi i Emisioneve /cilësisë së ajrit	Monitorimi i emisioneve / cilësisë së ajrit do të bëhet sipas kërkesave që dalin pasi të pajiset me Leje Mjedisore.
4.8.	Raportimet	Raportimet do të bëhen pasi të pajiste me Leje Mjedisore
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Disa prej masave kryesore janë: Menaxhimi i Pluhurit dhe Lëndëve të Dëmshme - Pluhuri është një nga ndotësit më të zakonshëm që lind nga grumbullimi dhe seleksionimi i mbeturinave, dhe mund të ndikojë në cilësinë e ajrit. Masat për të menaxhuar pluhurin përfshijnë:

		Sigurimi që mbeturinat të mbulohen gjatë grumbullimit dhe transportit për të parandaluar shpërndarjen e pluhurit në ajër. Duke përdorur lagështi për të ulur pluhurin dhe për të parandaluar shpërndarjen e tij në ajër.
4.10.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Kompania zbaton masa konkrete për të zvogëluar ndikimet në ndryshimet klimatike, përmes përdorimit të pajisjeve me efikasitet energjetik dhe mirëmbajtjes së rregullt të makinerive. Përdoren automjete me emetime të ulëta dhe optimizohet lëvizja e tyre për të reduktuar përdorimin e karburanteve fosile. Përmes riciklimit aktiv të mbeturinave plastike, metalike dhe letrës, kompania ndihmon në shmangien e deponimit dhe uljen e çlirimit të gazrave serrë si metani.

5. UJI

5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Shfrytëzimi i ujit nga kompania “Italy Recycling” SH.P.K. realizohet në sasi të kufizuar dhe përdoret kryesisht për qëllime sanitare (higjienën e stafit dhe objektit), për spërkatjen e sipërfaqeve të punës me qëllim reduktimin e pluhurit në ambientin e jashtëm, si dhe në mënyrë të kontrolluar në faza të caktuara si p.sh. gjatë larjes së mbeturinave plastike për qëllime riciklimi. Uji nuk përziehet me substanca të rrezikshme dhe nuk gjeneron mbetje të lëngshme të natyrës industriale, prandaj përdorimi i tij nuk paraqet rrezik për ndotje të mjedisit.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet e ujërave sipërfaqësore apo në rrjetin e kanalizimit	Shkarkimi i ujërave të përdorura nga kompania “Italy Recycling” SH.P.K. realizohet në rrjetin e kanalizimit të qytetit, përderisa uji shfrytëzohet vetëm për nevoja sanitare dhe për spërkatjen e sipërfaqeve të jashtme të punës, pa gjeneruar ndotje të natyrës teknologjike.
5.3.	Ndikimet në ujë	Aktiviteti i kompanisë “Italy Recycling” SH.P.K. nuk përfshin prodhimin e ujërave të ndotura me ngarkesë të lartë ndotëse dhe nuk përdor substanca të rrezikshme që mund të kontaminojnë mjedisin ujor. Uji përdoret në sasi të kufizuar për nevoja sanitare, për pastrimin dhe spërkatjen e sipërfaqeve të jashtme me qëllim kontrollin e

		pluhurit, si dhe në mënyrë të kontrolluar gjatë larjes së plastikës para se te vednoset materiali ne procesin e riciklimit. Ujërat e përdorura sanitare shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të qytetit, ndërsa proceset teknologjike nuk gjenerojnë mbetje të lëngshme me ndotës të rrezikshëm. Si rrjedhojë, ndikimi potencial në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore vlerësohet minimal.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Nuk ka ndikim në ndotjen e ujërave.
5.5	Trajtimi i ujërave tëndotura	Trajtimi i ujit nuk është i nevojshëm, pasi në kuadër të veprimtarisë së kompanisë “Italy Recycling” SH.P.K., uji përdoret vetëm për nevoja sanitare dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë në ambientet e punës, pa u përfshirë në procesin teknologjik të trajtimit dhe riciklimit të mbeturinave. Si rrjedhojë, ujërat e shkarkuara nuk përmbajnë ndotës të rrezikshëm dhe nuk paraqesin rrezik për mjedisin, prandaj nuk kërkohet zbatim i ndonjë sistemi të posaçëm për trajtimin e tyre.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Nuk është e nevojshme të bëhet kontrolli dhe matjet e ujërave, vetëm në rastet kur kërkohet dhe dyshohet për ndotje.
5.7.	Raportimi	Nuk është i nevojshëm
5.8.	Leje Ujore për shfrytëzim të ujit	Nuk është e nevojshme,
5.9.	Leje Ujore për shkarkimin e ujërave	Nuk është e nevojshme,
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Për të siguruar mbrojtjen e resurseve ujore dhe për të minimizuar çdo ndikim të mundshëm në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, kompania “Italy Recycling” SH.P.K. zbaton një sërë masash teknike dhe organizative në kuadër të veprimtarisë së saj. Edhe pse procesi teknologjik nuk gjeneron ujëra të ndotura industriale, përdorimi i ujit për qëllime sanitare, pastrim dhe larje teknologjike menaxhohet me kujdes për të shmangur ndotjen. Shkarkimi i ujërave të përdorura sanitare realizohet në rrjetin ekzistues të kanalizimit të qytetit, në përputhje me rregulloret lokale. Makineritë dhe pajisjet teknologjike

		kontrollohen rregullisht për të shmangur rrjedhjet e vajrave apo lëndëve të tjera ndotëse, ndërsa në rast të ndonjë rrjedhjeje, ndërhyhet menjëherë me materiale absorbente dhe mbetjet menaxhohen si mbetje të veçanta. Zona e magazinimit të vajrave të përdorura është e izoluar, me bazamente të papërshkueshme nga uji dhe me mbrojtje nga reshjet atmosferike, për të shmangur depërtimin në tokë dhe ujëra. Po ashtu, pastrimi i zonave operative kryhet me metoda të kontrolluara për të parandaluar përzierjen e ujërave të ndotura me rrjetin natyror.
--	--	--

6. ZHURMA		
6.1.	Burimet	“Italy Recycling” L.L.C. zona kadastrale Obiliq, Komuna e Obiliqit, qendra e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike, vajrave të përdorura dhe riciklimit të mbeturinave të plastikës, në domenin e mbrojtjes së mjedisit, ku zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin e nervor, në hipertension, në koncentrim e njeriut në punë etj. Lokacioni i objektit ku kryhet veprimtaria, burimet e zhurmës vijnë nga automjetet transportuese që nevojiten për transportimin e mbeturinave. Sipas gjendjes faktike të objektit në lokacionin e analizuar, si dhe duke marrë për bazë llojin e projektit, kapacitetin e impiantit dhe impianti është i vendosur në hapësira të mbyllura, mundë të konstatojmë se niveli zhurmës nuk ka ndonjë ndikim të theksuar në mjedis.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Si pasojë e lëvizjes së automjeteve për transport, pajisjeve punuese, mundë të vie deri te ngritja e zhurmës. Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë

		njerëzit
6.3.	Raportimet	Raportimi i zhurmës do të bëhet sipas kushteve që do të dalin nga leja mjedisore, do të bëhet matja dhe do të raportohet në MMPHI.

7. TOKA

7.1	Ndikimet në tokë	Aktiviteti i kompanisë “Italy Recycling” L.L.C., i cili përfshin grumbullimin, trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave, mund të shkaktojë ndikime të kufizuara në komponentin e tokës, kryesisht si rezultat i operacioneve të përditshme teknologjike. Ndikimet potenciale përfshijnë ndotjen aksidentale të sipërfaqes së tokës nga rrjedhjet e vajrave të përdorura, derdhjet e paqëllimshme të mbetjeve të papastra, si dhe depozitimin jo të kontrolluar të materialeve që përmbajnë substanca të ndotshme. Gjithashtu, lëvizja e shpeshtë e mjeteve transportuese dhe makinerive në zonën operative mund të çojë në degradim fizik të sipërfaqes së tokës, si dhe ngritjen e pluhurit të imët që përhapet në tokë përreth. Nëse nuk menaxhohen me kujdes, këto ndikime mund të kontribuojnë në përkeqësimin lokal të cilësisë së tokës dhe, në raste të rralla, edhe në infiltrimin e ndotësve në shtresat më të thella të saj.
7.2	Masat për zvogëlimin endikimeve në tokë	Për të minimizuar ndikimet e mundshme në tokë nga aktiviteti i trajtimit dhe riciklimit të mbeturinave, kompania “Italy Recycling” L.L.C. zbaton masa mbrojtëse për të parandaluar ndotjen e drejtpërdrejtë apo indirekte të sipërfaqes tokësore dhe shtresave nëntokësore. Në zonat operative dhe magazinuese, janë ndërtuar sipërfaqe të papërshkueshme nga vajrat, të cilat parandalojnë infiltrimin e substancave potencialisht ndotëse në tokë. Makineritë dhe pajisjet teknologjike kontrollohen dhe mirëmbahen

		rregullisht për të shmangur rrjedhjet e vajrave apo karburanteve. Në rast rrjedhjesh aksidentale, ndërhyhet menjëherë me materiale absorbente dhe mbetjet menaxhohen si mbetje të veçanta, sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, janë vendosur zona të dedikuara për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve, të cilat janë të mbuluara dhe të ndara sipas llojit, duke shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë me tokën. Lëvizja e mjeteve dhe ngarkim-shkarkimi i mbeturinave bëhet në sipërfaqe të forta dhe të qëndrueshme, për të shmangur dëmtimin fizik të strukturës së tokës. Këto masa sigurojnë që aktiviteti i kompanisë të zhvillohet pa rrezikuar ndotjen apo degradimin e komponentit tokësor.
7.3	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Pas përfundimit të aktivitetit, kompania “Italy Recycling” L.L.C. do të ndërmarrë veprime të plota për rehabilitimin e zonës, me qëllim eliminimin e çdo ndikimi të mundshëm mjedisor dhe rikthimin e hapësirës në një gjendje të sigurt dhe të qëndrueshme. Ky proces do të realizohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi. Pastrimi i plotë i zones - Pas ndërprerjes së veprimtarisë, do të realizohet pastrimi i plotë i objektit dhe hapësirave përreth nga të gjitha: mbeturinat e mbetura, pajisjet teknologjike, kontenierët, materialet ndihmëse dhe ndotësit potencialë. Kontrolli dhe analiza e tokës - Do të kryhet inspektim teknik dhe analizë laboratorike për të verifikuar gjendjen e tokës dhe identifikimin e mundshëm të ndotjes së shkaktuar gjatë operimit. Në rast se evidentohen ndotje, kompania do të zbatojë masa të menjëhershme për pastrimin dhe dekontaminimin e zonës. Menaxhimi i infrastrukturës ekzistuese - Sipërfaqet e betonizuara dhe ndërtimet ndihmëse do të kontrollohen për siguri dhe qëndrueshmëri. Strukturat që nuk do të kenë më funksion pas përfundimit të aktivitetit do të largohen, dhe zona do të sistematizohet për qëllime të mëtejshme përdorimi. Rikultivimi i zones - Pas pastrimit dhe eliminimit të mbetjeve të

		qëndrueshme, toka do të rikthehet në gjendje të natyrshme ose në funksion tjetër të përcaktuar nga autoritetet. Nëse zona do të shfrytëzohet për përdorim të mëvonshëm do të ndërmerren hapat përkatës për përgatitjen dhe rehabilitimin e saj. Dokumentimi dhe raportimi - Kompania do të përgatisë një plan të mbylljes dhe raport për rehabilitimin e zonës, që do t'i dorëzohen autoriteteve përkatëse, si dëshmi e përmbushjes së obligimeve mjedisore pas mbylljes së veprimtarisë.
--	--	--

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1

.

Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas katalogut shtetëror të mbeturinave

Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi i tyre - mbeturinat të cilat gjenerohen gjatë aktivitetit të objekti i qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, janë mbeturinat komunale, te cilat deponohen në kontejner dhe pastaj kompania e cila kujdeset per mbeturinat e qytetit i bartën me kamionë 1 here ne javë, të cilat i dërgojnë në deponinë e mbeturinave te qytetit. Objekti i qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura “Italy Recycling” L.L.C., Klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave kompania e bënë në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina.

Sipas katalogut shtetëror kemi te bëjmë me mbeturina komunale siç janë:

Mbeturi na	Emri i mbeturinës	Shkalla rrezikshmëri së	Lloji i deponimit
20 01 01	Letra dhe Kartoni	Jo të	Kontejner

				rrezikshme	
		20 01 39	Plastika	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
		20 01 08	Mbeturinat e ngurta komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
8.2 .	Përshkrimi i Magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Mbeturinat e ngurta komunale, grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor. 			
8.3 .	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Gjatë funksionimit të kompanisë “Italy Recycling” L.L.C., përveç mbetjeve që trajtohen sipas kodeve përkatëse të mbeturinave, krijohen edhe sasi të vogla të mbeturinave nga aktivitetet e punonjësve (mbeturina organike, plastike, letër, etj.). Mbetjet e riciklueshme të krijuara nga punonjësit (si letër dhe plastikë) riciklohen brenda objektit përmes linjës së trajtimit ekzistuese. Mbetjet e ngurta komunale, që nuk përfshihen në procesin e riciklimit, grumbullohen në mënyrë të veçantë dhe vendosen në kontejnerë të dedikuar dhe të mbyllur me kapak, të vendosur në hapësirë të përcaktuar. Këto mbetje menaxhohen dhe largohen nga operatori komunal i kontraktuar i qytetit, njëjtë si mbetjet urbane të zakonshme.			
8.4 .	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër – kontrate me kompaninë me leje përkatëse	Pasi kjo është qendër e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, ku të gjitha mbeturinat pas përpunimit, trajtimit fizik dhe riciklimit si (Granula) do shiten tek kompani të ndryshme.			
8.5 .	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Kompania “Italy Recycling” L.L.C. ka të hartuar Planin e Menaxhimit të Mbeturinave vetëm për ato lloje mbeturinash që përfshihen në kodet			

		e mbeturinave të cilat trajtohen brenda objektit dhe procesit teknologjik (si plastika, letra, metale, qelqi dhe vajrat e përdorura). Për mbeturinat e tjera që nuk përfshihen në këto kode, siç janë mbeturinat komunale të krijuara nga stafi (p.sh. ambalazhe ushqimore, mbeturina higjienike, etj.), kompania aktualisht nuk ka të hartuar Plan të veçantë për menaxhimin e tyre, por ato menaxhohen përmes sistemit të rregullt të grumbullimit dhe deponimit të organizuar nga kompania komunale për mbeturina.
8.6	Raportimi	Nuk bëhet raportimi

9. RREZIKU NGA AKSIDENTET		
9.1	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mundshme që lidhen me aktivitetin e kompanisë “Italy Recycling” L.L.C., e cila operon me mbledhjen, trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave si plastika, letra, metale, qelq dhe vajra të përdorura, nuk identifikohet ndonjë rrezik i madh potencial. Veprimtaria është e natyrës mekanike dhe zhvillohet në ambiente të kontrolluara, me teknologji të zakonshme riciklimi. Rreziku i vetëm i mundshëm mund të lidhet me sistemet e energjisë elektrike, si p.sh. mbingarkesa në instalime apo defekte teknike në makineri, që mund të shkaktojnë ndonjë zjarr të lokalizuar.
9.2	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Objekti i qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura “Italy Recycling” L.L.C., nuk përdorë substanca të rrezikshme kimike dhe preparate.
9.3	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave objekti i qendrës së mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit, dhe riciklimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura “Italy Recycling”

		L.L.C., ka marrë këto masa: Bëhet përdorim i drejt, mbikëqyrja e rregullt dhe mirë mbajtje e pajisjeve. Ofrimi i pajisjeve mbrojtëse personale, si doreza, syze mbrojtëse, maska dhe veshje të tjera të sigurta. Kompania i ka marrur te gjitha masat duke siguruar aparate për fikjen e zjarrit.
9.4	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Kompania ne fjale ka bere raportin mbi gjendjen e sigurise nga rreziqet

10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT

10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Nuk ka ndërprerja momentale të punës së fabrikës.
10.2.	Ndërprerja e punës	Nuk ka ndërprerje të punës.

11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT

Gjatë funksionimit të vazhdueshëm të kompanisë “Italy Recycling” L.L.C., e cila ushtron aktivitetin në zonën kadastrale të Obiliqit, me fokus në mbledhjen, grumbullimin, trajtimin fizik, ripërdorimin, përpunimin, magazinimin dhe riciklimin e mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit, mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, ndikimi i mundshëm në shëndetin e njeriut vlerësohet të jetë shumë i ulët. Procesi teknologjik është kryesisht mekanik dhe zhvillohet në ambiente të mbyllura apo të kontrolluara, pa përfshirje direkte të substancave të rrezikshme kimike apo ndotësve të dëmshëm për shëndetin publik. Të gjitha pajisjet që përdoren në proces – përfshirë linjat e seleksionimit, presat, granulorët, sistemet e larjes dhe tharjes – janë të mirëmbajtura dhe funksionojnë në përputhje me standardet teknike dhe të sigurisë, duke siguruar kontroll efektiv mbi pluhurin, zhurmën dhe emisionet e mundshme difuzive. Gjithashtu, objekti ndodhet në një distancë prej rreth 290 metrash nga shtëpi banimi më të afërta, duke ndihmuar në minimizimin e ekspozimit të komunitetit përreth ndaj çdo ndikimi potencial. Po ashtu, objekti nuk ndodhet në afërsi të zonave të ndjeshme ekologjikisht apo zonave të mbrojtura. Bazuar në këta faktorë, mund të konstatohet se veprimtaria e kompanisë “Italy Recycling” L.L.C. nuk përbën rrezik për shëndetin e njeriut, ndërsa ndikimet e mundshme janë të menaxhueshme përmes zbatimit të masave teknike dhe operationale në përputhje me standardet mjedisore dhe ligjore.

Ky përshkrim është hartuar me qëllim informimi dhe mbështetje të aplikimit për Leje Mjedisore, pas marrjes së Pëlqimit Mjedisor nga autoritetet përkatëse.

Personi Përgjegjës për Mjedis

Emri Mbiemri

Fidan Latifaj

Nënshkrimi




Personi përgjegjës i Kompanisë

Emri Mbiemri

Fidan Latifaj

Nënshkrimi